

Dokumentimi i mallrave

Tatimpaguesit që mbajnë, tregtojnë, përdorin ose transportojnë mallra duhet të kenë dokumentet e nevojshme tatimore, që provojnë pronësinë ose kontrollin mbi këto mallra. Me kërkesën e zyrtarëve të Administratës Tatimore i vënë këto dokumente në dispozicionin e tyre.

Të gjithë personat e tatueshëm, subjekte të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar apo të Tatimit mbi Fitimin dhe personat e tatueshëm, tatimpagues i Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin e biznesit të vogël, mallrat gjendje në çdo vend biznesi, mallrat në transport apo mallrat në përdorim për çfarëdo arsye qofte, janë të detyruar t'i justifikojnë me dokumentin e nevojshëm tatimor.

Dokumenti i nevojshëm tatimor që provon pronësinë apo kontrollin mbi mallrat gjendje dhe në përdorim janë:

- Faturat tatimore të TVSH-së
- Faturat e thjeshta tatimore
- Dokumentacioni i prodhimit

Si dokument i nevojshëm tatimor, që provon pronësinë apo kontrollin mbi mallrat gjatë transportit është fatura tatimore e TVSH-së, fatura e thjeshtë tatimore ose fatura e shoqërimit të mallit. Në rastet kur mallrat që transportohen nuk janë destinuar për shitje, por për lëvizje të brendshme të mallrave nga magazina në magazinë; nga magazina në dyqan apo anasjelltas; nga qendra në filial; nga vendi i prodhimit në magazinë; nga vendi i prodhimit në dyqan, etj. është i detyruar të lëshojë faturën e shoqërimit të mallit.

Fatura e shoqërimit të mallit lëshohet edhe në rastin e shitjeve “derë më derë”. Në këtë rast, në momentin e lëvizjes së mallit nga magazina e shitësit apo nga vendi i tij i prodhimit në mjetet e tij të transportit, nëpërmjet të cilëve do të realizohen shitjet “derë më derë”, personi i tatueshëm, subjekt i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar apo i Tatimit mbi Fitimin, lëshon një faturë shoqërimi malli. Kurse në momentin e realizimit të çdo shitje të mallrave “derë më derë”, personi i tatueshëm lëshon për blerësin faturë tatimore me TVSH.

Për mallrat e importuara nga jashtë vendit, që transportohen nga dogana ku zhdoganohet malli në drejtim të magazinës së personit të tatueshëm importues, si dokument për lëvizjen e mallit do të shërbejë deklarata doganore e importit e lëshuar nga administrata doganore,

shoqëruar edhe me faturën e lëshuar nga furnitori i huaj i mallit. Në raste furnizimesh të mëdha, ku për lëvizjen e mallit nga dogana në magazinën apo magazinat e personit të tatueshëm importues, kërkohen disa mjete dhe ngarkesa transporti, si dokument për lëvizjen e mallit do të shërbejë një dokument shoqërimi i mallit, si fatura e shoqërimit, kur mund të lëshohet nga importuesi për çdo mjet transporti dhe për çdo ngarkesë ose një dokument i lëshuar nga agjencia speditore/ agjencia doganore për çdo mjet transporti dhe për çdo ngarkesë, së bashku me një fotokopje të deklaratës doganore të importit dhe të faturës së lëshuar nga furnitori i huaj i mallit.

Fleta e shoqërimit të mallit, përdoret për të shoqëruar mallin gjatë transportit, vetëm në rastin kur transaksioni është kryer sipas kushteve të parashikuara: Në rastin kur një person i tatueshëm (shitësi) furnizon (shet) mallrat për një person tjetër të tatueshëm (blerës), por lëvizja e mallrave nëpërmjet transportit nuk kryhet në drejtim të personit të tatueshëm blerës-rishitës, por në drejtim të një personi të tretë (pritësi/blerësi i tretë)

KUJDES!

Kur gjatë kontrolleve që ushtrohen nga strukturat e Administratës Tatimore, konstatohet se mungon dokumentacioni i kërkuar ligjor për dokumentimin e mallit, zbatohen masat administrative, si më poshtë:

Tatimpaguesi i regjistruar:

a) Tatimpaguesi i Tatimit të Thjeshtuar të Fitimit, që nuk është i regjistruar për TVSH-në, menjëherë në momentin e konstatimit i ndryshohet përgjegjësia tatimore duke kaluar si tatimpagues i TVSH-së. Për qëllim të konstatimit të mosdokumentimit të mallit detyrohet të lëshojë faturë ku evidentohet si blerës, me qëllim dokumentimin e mallit dhe dënohet me gjobë të barabartë me 100% të tatimit të padokumentuar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore.

b) Tatimpaguesi i regjistruar për TVSH-në detyrohet të dokumentojë mallin duke lëshuar faturë tatimore, ku evidentohet si blerës, me qëllim dokumentimin e mallit. Për qëllim të konstatimit të mosdokumentimit të mallit i kryhet rivlerësim i shitjeve në të njëjtën vlerë me vlerën e tregut të mallit të padokumentuar dhe dënohet me gjobë të barabartë me 100% të tatimit të padokumentuar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe



kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore.

Person i identifikuar i paregjistruar

Personi i identifikuar i paregjistruar, (i papajisur me NIPT), për sasinë e mallit që mban në ruajtje, përdor ose transporton, dënohet me gjobë të barabartë me 100% të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore.

Gjithashtu në përputhje me dispozitat ligjore, Administrata Tatimore kur konstaton se janë përmbushur kushtet e evazionit tatimor ushtron të drejtën për kallëzuar penalisht tatimpaguesin.